# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457422**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Krim brenda familjes në Tiranë/ I moshuari godet me thikë gruan, 58-vjeçarja ndërron jetë në spital. Autori kapet pas disa orësh arrati (EMRAT+ VIDEO) |
| ADRESA | `https://dosja.al/live-updates/-ne-familje-i-moshuari-godet-me-thike-gruan-humb-jeten-ne-spita-i514985` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 10:44:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 10:28:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2b8692fced37ee0a3ab78ec9de61b5006f5b3d88e0de79bc4f1f3d4ac3475a98` |
| TEKSTI | `b0ff27d592450be4aa898b06751a9c4d95b2b57036b21602c3009053bdf6d72a` |
| PAMJA | `a31cb4cf08b19e70737227d81cc8b489c8328b988f37977b6450520fbc937986` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `56848c1b66466f4275dcb9f7eaf47e84288f4a3bc139fc7df3bac50c87804fee` |
| E MËPARSHMJA | `4c8eff3418de41074b4f308bc59b62641e2c74181661c4e4aac1e29bb49d5b94` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/56848c1b66466f4275dcb9f7eaf47e84288f4a3bc139fc7df3bac50c87804fee`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

6 ORE ME PARE
112 ditë protesta kundër qeverisë/ Qytetarët mblidhen sërish në Bulevard, kërkojnë ndryshimin e Kodit Zgjedhor

11 ORE ME PARE
"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

14 ORE ME PARE
Krim brenda familjes në Tiranë/ I moshuari godet me thikë gruan, 58-vjeçarja ndërron jetë në spital. Autori kapet pas disa orësh arrati (EMRAT+ VIDEO)

1 DITE ME PARE
111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

LIVE UPDATES

# Krim brenda familjes në Tiranë/ I moshuari godet me thikë gruan, 58-vjeçarja ndërron jetë në spital. Autori kapet pas disa orësh arrati (EMRAT+ VIDEO)

• Krim në familje në Tiranë. • Një grua me emrin Lumturie Patushi është vrarë me thikë nga bashkëshorti i saj Hysni Patushi në Tiranë. • Ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:20 në një banesë në rrugën "Panorama", në zonën pas shkollës "Harry Fultz". • Dyshohet se pas një konflikti në banesë 68-vjeçari ka goditur me mjet prerës bashkëshorten e tij 58 vjeçe. • Gruaja është transportuar me urgjencë në spital, por ka humbur jetën si pasojë e plagëve. • Në momentin e ngjarjes, në banesë ndodhej edhe nipi 14-vjeçar dhe dhëndëri i tyre, i cili është shoqëruar në Polici. • Pas krimit, Patushi është larguar nga vendngjarja për disa orë dhe më pas është arrestuar nga policia. • Para autoriteteve, Patushi ka rrëfyer se kishin konflikte me bashkëshorten herë pas here, pasi ajo qëndronte te shtëpia e vajzës dhe jo në banesën e tyre. • Sipas dëshmisë së tij, Patushi i kishte kërkuar gruas të shkonte në shtëpinë e tyre, por ajo nuk pranonte. • Ai thotë se paraditen e sotme, e kishte marrë në telefon dhe gruaja i ka thënë se ndodhej te TEG-u dhe ku 68-vjeçari ka shkuar te shtëpia e vajzës e ka gjetur aty. • Patushi thotë me tej se në debat e sipër e ka goditur me thikë në zemër.

6 artikuj për këtë temë.

10 ORE ME PARE

## "Kishim konflikte herë pas here"/ Vrau me thikë gruan, flet  68-vjeçari: Qëndronte te shtëpia e vajzës, i kërkoja të vinte në banesën tonë



Hysni Patushi

**TIRANË**- 68-vjeçari, i cili vrau me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, brenda banesës së tyre në zonën e Zogut të Zi në Tiranë është marrë në pyetje nga grupi hetimor. Para autoriteteve, Hysni Patushi ka rrëfyer se kishin konflikte me bashkëshorten herë pas here, pasi ajo qëndronte te shtëpia e vajzës dhe jo në banesën e tyre.

Sipas dëshmisë së tij, Patushi i kishte kërkuar gruas të shkonte në shtëpinë e tyre, por ajo nuk pranonte. Ai thotë se paraditen

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 16:07
"Kishim konflikte herë pas here"/ Vrau me thikë gruan, flet  68-vjeçari: Qëndronte te shtëpia e vajzës, i kërkoja të vinte në banesën tonë

e sotme, e kishte marrë në telefon dhe gruaja i ka thënë se ndodhej te TEG-u dhe ku 68-vjeçari ka shkuar te shtëpia e vajzës e ka gjetur aty. Patushi thotë me tej se në debat e sipër e ka goditur me thikë në zemër.

*"Në debat e sipër e kam goditur me thikë në zemër"*, citohet të ketë dëshmuar ai në polici.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:20 në një banesë në rrugën "Panorama", në zonën pas shkollës "Harry Fultz". Pas goditjes me thikë, gruaja është transportuar me urgjencë në spital, por ka humbur jetën si pasojë e plagëve. Në momentin e ngjarjes, në banesë ndodhej edhe nipi 14-vjeçar dhe dhëndëri i tyre, i cili është shoqëruar në Polici. Pas krimit, Patushi është larguar nga vendngjarja për disa orë dhe më pas është arrestuar nga policia./**Dosja.al**

13 ORE ME PARE

# Vrau gruan me thikë brenda në banesë, del fotoja e 68-vjeçarit



Hysni Patushi

**TIRANË**- Hysni Patushi dyshohet se vrau me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, brenda banesës së tyre në zonën e Zogut të Zi në Tiranë. Ngjarja është raportuar rreth orës 10:20, pasi policia është njoftuar për një plagosje me mjet prerës brenda familjes.

Në banesë mbërriti menjëherë ekipi i urgjencës mjekësore, por konstatoi se Lumturie Patushi kishte ndërruar jetë. Sipas të dhënave paraprake, 58-vjeçarja kishte marrë një plagë të thellë në pjesën e djathtë të kraharorit. Pas ngjarjes, Hysni Patushi u largua nga banesa, ndërsa më vonë u dorëzua në polici./**Dosja.al**

13 ORE ME PARE

# Vrau gruan me thikë, dorëzohet në polici Hysni Patushi




**TIRANË**- Hysni Patushi është dorëzuar në polici pasi dyshohet se vrau me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, në Tiranë. Ngjarja e rëndë ndodhi në një banesë në rrugën "Panorama", në zonën pas shkollës "Harry Fultz". Sipas të dhënave paraprake, çifti kishte pasur probleme edhe më herët.

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 15:36
"Manipulimi me AI gati sa nuk shkaktoi përplasje SHBA-Kinë", CNN: Ushtria amerikane u përgatit të sulmonte një anije kineze

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:14
EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar

më të klikuarat

"Turp dhe faqe e zezë"/ Zhupa: Hiqeni menjëherë shgarravinën si Çerçiz Topulli në Muzeun e Gjirokastrës! E papranueshme dhe fyese

Sekuestrohen mbi 414 kg hashash me vlerë mbi 4 milionë euro, arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali

Trafik heroine dhe kokaine në Francë/ Goditet sërish rrjeti kriminal i shqiptarëve, dy në pranga nga grupi 'Ronaldo' (EMRAT)

EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

**Njoftimi i policisë:**

*Tiranë Vrau me mjet prerës bashkëshorten, vihet në pranga 68-vjeçari. Në vijim të informacionit paraprak të dhënë pak më parë, bëjmë me dije se, shtetasi H. P., 68 vjeç, i dyshuar se ka goditur me mjet prerës bashkëshorten e tij, shtetasen L. P., 58 vjeçe, e cila si pasojë ka humbur jetën, është lokalizuar dhe vënë në pranga nga shërbimet e Policisë. Grupi hetimor vijon punën për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit.*

Në momentin e ngjarjes, në banesë ndodheshin dy të mitur dhe dhëndri i çiftit, i cili jetonte në të njëjtën banesë. Ata janë marrë në pyetje nga policia për të hedhur dritë mbi rrethanat e krimit. Lumturie Patushi u transportua me urgjencë në spital, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra./**Dosja.al**

Moti
Powered by tomorrow.io

14 ORE ME PARE

# Krimi brenda familjes, policia jep detajet: Autori në kërkim




Policia

**TIRANË**- Policia ka dhënë detaje të reja për krimin e rëndë të ndodhur në rrugën "Panorama" në Tiranë, ku një 68-vjeçar dyshohet se ka vrarë me mjet prerës bashkëshorten e tij. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:20, pas një konflikti në banesë.

Hysni Patushi, 68 vjeç, dyshohet se ka goditur me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, 58 vjeçe, e cila si pasojë e plagëve ka humbur jetën. Pas ngjarjes, 68-vjeçari është larguar nga vendngjarja dhe është shpallur në kërkim nga policia.



[redacted]

**Njoftimi i Policisë:**

*Tiranë/Informacion paraprak Rreth orës 10:20, në rrugën "Panorama", dyshohet se, pas një konflikti në banesë, shtetasi H. P., 68 vjeç, ka goditur me mjet prerës bashkëshorten e tij, shtetasen L. P., 58 vjeçe, e cila ka humbur jetën. Autori i dyshuar, shtetasi H. P., 68 vjeç, është larguar nga vendngjarja. Vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e tij, si dhe për dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.***/Dosja.al**

14 ORE ME PARE

# EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar




Policia

**TIRANË-** Detaje të reja kanë dalë në lidhje me krimin në familje në Tiranë. Mësohet se Hysni Patushi dyshohet se ka vrarë me thikë bashkëshorten e tij, Lumturie Patushi, në një kompleks banimi në zonën e Zogut të Zi në Tiranë.

Ngjarja ka ndodhur pas shkollës "Harry Fultz", ndërsa në banesë ndodhej edhe nipi 14-vjeçar. Lumturie Patushi u transportua me urgjencë në spital, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra. Ndërkohë, policia ka shoqëruar edhe dhëndrin e autorit.

Pas ngjarjes, Hysni Patushi është larguar nga vendngjarja dhe është shpallur në kërkim nga policia. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe motivit të krimit.**/Dosja.al**

14 ORE ME PARE

# Krim në familje/ Burri godet me thikë gruan, humb jetën në spital për shkak të plagëve



Policia

**TIRANË-** Një krim i rëndë ka ndodhur pak minuta më parë në zonën e Zogut të Zi në Tiranë, ku një burrë dyshohet se ka goditur me thikë bashkëshorten e tij. Gruaja u transportua me urgjencë në spital, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra dhe ndërroi jetë.

Ngjarja ka ndodhur në një kompleks pranë zonës së Harry Fultz. Pas krimit, autori i dyshuar është larguar nga vendngjarja dhe është shpallur në kërkim nga policia.

Forcat e policisë po punojnë për lokalizimin dhe arrestimin e tij, ndërsa grupi hetimor vijon veprimet për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe shkaqeve të ngjarjes./**Dosja.al**

lumturie patushi | hysni patushi | krim ne familje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.